

MarkantColor NGJYRA TË NDRYSHME



Shkallë e njëtrajtshme shkëlqimi dhe pamje e plotë

Vaj dylli të fortë natyral, i ngjyrosur. Vajrat me cilësi të lartë që krijojnë shtresë nxjerrin në pah natyralitetin e drurit dhe njëkohësisht arrijnë rezistencë të lartë ndaj ndotjes dhe ujit.

- Formon membranë, rezistent ndaj fërkimit
- Pamje e njëtrajtshme dhe e plotë
- Zmbraps ujin dhe papastërtitë
- Përpunimi i shpejtë dhe i sigurt
- Thekson bukurinë natyrale të drurit
- Të gjitha variantet mund të përziehen me njëri tjetrin
- I përshtatshëm për lodra për fëmijë në përputhje EN 71-3

Gama e përdorimit:

Për ngjyrosje profesionale parketesh dhe dyshemesh druri. Sugjerohen sipas preferencës drurë me pore të mëdha si lisi etj. Të përshtatshme pothuajse për të gjitha llojet e drurëve europianë dhe ekzotikë. Shih katalogun me llojet e drurit që do ta gjeni në faqen e internetit www.loba.de. Në rast dyshimi konsultohuni me fabrikën.



Loba GmbH & Co. KG
Emissionsgeprüftes Bauprodukt
nach DIN-Grundsätzen
Z-157.10-193



Të dhëna teknike të produkteve

Nr. Artikulli

10508



750 ml



6



480

Të gjitha ngjyrat disponohen në mostra 100 ml.

Solide

58,4 ±2%

Përbërësit

hidrokarbure alifatike, vajra vegjetalë të modifikuar, pigmente ngjyruës, substanca tharëse pa kobalt, dyll vegjetal, lëndë aktive anionike

Magazinimi dhe transportimi

36 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit. Material i parrezikshëm sipas ADR. Nuk ndikohet nga ngrica.

GISCODE

Ö60

2004/42/CE

Vlera e lejueshme i BE-së për produktin (Kat. A/i): 500g/l (2010).
Ky produkt përmban maksimumi 476g/l VOC.



MarkantColor NGJYRA TË NDRYSHME



Të dhëna teknike të produkteve

Ngjyra të bazës							
	900005 I zi	900126 I bardhë	900148 Gri				
Ngjyrat e drurit							
	800099 Mogan	800127 Dru arre	800132 Lis i tymosur	800145 Kambala	800149 Sucupira	800150 Wenge	800200 Antique Oak
Ngjyrat e trendit							
	700133 Papirus	900127 Chalk	900143 Oyster	900144 Clay	900145 Sand	900146 Pearl	900147 Silver

Pa garanci për ngjyrën



Udhëzime përpunimi

- Sipërfaqja duhet të jetë lëmuar siç duhet. DysHEMEJA duhet të jetë e thatë, pa shtresa të vjetra, vaj, yndyra, dyll, silikon, pluhur lëmimi dhe papastërti të tjera.
- Kushtet optimale të përpunimit eksitojnë në një temperaturë mjedisi nga +15°C deri + 25°C, temperaturë dysHEMEJE +15°C deri +22°C, lagështirë relative të ajrit 40% - 65%, temperaturë të materialit +18°C - + 25°C, lagështirë maksimale të drurit 12%, ajrosini mjaftueshëm mjediset e punës.
- Për të parandaluar dëmtimet e parketit duhet që gjatë përpunimit të synohet klima e pritshme e mjedisit që pritet në mesin e vitit.
- Para aplikimit transferoni materialin në një kovë LOBATOOL.
- Tundni mirë materialin.
- Cilësitë e drurit të përdorur, struktura dhe poret, si dhe kualiteti i motivit lëmuës ndikojnë intensivisht në nuancën e ngjyrës që arrihet. Rekomandojmë patjetër krijimin e mostrës së ngjyrës mbi drurin origjinal - pasi është lëmuar me teknikën e përshtatshme, për të kontrolluar ju vetë rezultatin dhe nëse nevojitet për ta miratuar klienti pët të cilin punoni.
- Duhet të merren parasysh "Udhëzime rrashinimi - Ngjyrosje të dysHEMEVE parketi" të LOBA-s.
- Para përdorimit të varianteve me ngjyra, rekomandojmë aplikime provë për të vlerësuar tonin e ngjyrës që mund të arrihet dhe efektin e përgjithshëm vizual. Ngjyrat mund të përzihen me njëra tjetrën. Për të krijuar një nuancë më të hapur ose për të reduktuar kapacitetin e mbulimit mund të shtohet varianti transparent. Për pamje të njëtrajtshme të ngjyrës nevojitet mbushje me pigment ngjyruës, kështu që hollimi lejohet të bëhet maksimumi në raport tre pjesë transparent dhe një pjesë ngjyrë.
- Nëse për sipërfaqe të mëdha nevojitet më shumë se një kuti, duhet të përzihet e gjithë sasia e nevojshme para fillimit të punës në një enë të madhe.
- Në sipërfaqe të lagura me ujë, për arsye të depërtimit të thellë të pigmenteve ngjyruese te druri, kthimi në gjëndjen origjinale të sipërfaqes nuk është i mundur.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në www.wingis-online.de.
- Ky produkti është pjesë integrale e "Connected Systems" të LOBA dhe Wakol. Kombinimet e miratuara me materialet ngjyrtëse të parketit Wakol i gjeni në "Connected Systems Matrix": www.loba.de/connected-systems

Hollues

Për të krijuar një nuancë më të hapur ose për të reduktuar aftësinë e mbulimit përzihet Markant mat. Max. 3 pjesë transparent dhe 1 pjesë ngjyrë.

Mjet aplikimi / Normë aplikimi

Lyerje me shpatull: LOBATOOL Shpatull / përafër. 20ml/m² (50m²/l)

Lyerje me rulon ose furçë: LOBATOOL Rulon Microfaser 60-80 ose LOBATOOL Furçë vaji / përafër. 60-100ml/m² (12m²/l)

Koha e tharjes

- Ngjyrosje të paktën pas 12 orësh.
- Megjithatë brënda 24 orëve.
- Mund të ecet pas 12 orëve.
- Mund të përdoret pas 24 orëve.
- Mbulim pas 10 ditësh.
- Mbulimi i shpejtë mundosohet me LOBATOOL Cover 400, për detaje shih informacionet teknike të produktit.

MarkantColor

NGJYRA TË NDRYSHME



Udhëzime përpunimi

Përdorimi MarkantColor:

Në veçanti për ngjyrosjen sugjerojmë të mbani parasysh rekomandimet për lëmim "Udhëzime lërimi:: Ngjyrosja e dysHEMEVE me parket"

- Aplikoni me kujdes MarkantColor me shpatull LOBATOOL seksion pas seksioni. Në dysheme të vjetra me lidhje apo dërrasa me anë të lëmuara përdorni rul LOBATOOL Microfaser 60-80 si shtupë (mos e përdorni si rul).
- Menjëherë pastaj rrafshoni me aparat me disk dhe me LOBASAND SpecialPad bezhë.
- Lëreni të thahet për një natë, maksimumi 24 orë.
- Aplikoni njëtrajtësisht një shtresë të hollë Markant transparent me rul vaji LOBATOOL Microfaser 60-80. Te ngjyrat e çelëta MarkantColor Farben, si alternativë me versionin transparent mund të aplikohet MarkantNature.

Informacion i rëndësishëm

Në rastin e kohës së tharjes mbi 24 orë, para aplikimit të shtresës së dytë duhet të kryhet rrashinim i ndërmjetëm. Kjo nuk është e mundur në rastin e MarkantColor, kështu që periudhat e ndërmjetme të tharjes duhet të respektohen me korrektësi. Përndryshe do lindin probleme aderimi.

Rruani copat e lagura, pads dhe mjetet e tjera të punës në kuti të mbyllura. Vaji bashkë me pluhurin lëmues, copat e.t.j duhet të lagen me ujë ose të mbahen të mbyllura në kuti ose të hidhen poshtë, për të evituar kështu rrezikun e zjarrit - ndryshe ekziston rreziku i vetëndejes.

Aplikimet me shpatull janë të mundshme vetëm në dysheme druri me fuga hermetike. Vaji që ka depërtuar brënda në fuga nuk thahet plotësisht për një periudhë kohe të gjatë.



MarkantColor NGJYRA TË NDRYSHME



Udhëzime të përgjithshme

Pastrimi i mjeteve të punës: Pastroni mjetet e punës me tretës, si p.sh. pastrues furçash.

Koha e tharjes: Koha e tharjes e përmendur është e vlefshme për temperaturë +20°C dhe lagështi relative të ajrit 50%, si dhe ajrosje të vazhdueshme të ambientit të punës, pa rryma ajri. Temperaturat më të ulta, lagështia relative e lartë, mosajrosja e duhur vonojnë tharjen. Pa arritur forcimin (tharjen) e plotë mos pastroni dhe mos shtroni tapete. Për mbulimin e sipërfaqes para tharjes së plotë përdorni LOBATOOL Cover 400. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

Ngjitje e cepave: Parketet që nuk janë ngjitur në mënyrë të qëndrueshme, dyshemetë me dërrasa druri, dyshemetë me veshje druri, parketet industriale, parketet mbi dysheme me system ngrohje si edhe llojet e drurit me kohë të shkurtër ndryshimi të lagështirës (p.sh. ahu) shfaqin ndryshime dimensionale në varësi të luhatjes së klimës së ambientit (lagështia relative e ajrit, temperatura). Me aplikimin e vajit në anët ngjetëse nuk shfaqen plasaritje të fugave .

Ndërveprime: Materiale të tilla si p.sh. nënshtresat e tapeteve, këmbët dhe rrotat e mobiljeve, ngjitësat elastikë për ngjitje ose fiksion të parketeve mund të shkaktojnë zbutje dhe çngjyrosje. Materiale ndërtimi të lëna mbi lidhjet mund të ndikojnë negativisht në prekje dhe në pamje. Ekspozimi në bojra floku, goma makinash, motorash, biçikletash, gjithashtu mund të shkaktojnë çngjyrosje të përhershme dhe të pandryshueshme të sipërfaqes.

Udhëzime sigurie: Gjatë procesit të tharjes së produkteve me përmbajtje të lartë tretësi krijohen avuj të ndezshëm. Për këtë arsye ndalohet zjarri, drita e zhveshur, saldimi, pirja e duhanit, etj në distance të afërt me këto produkte. Ajrosni mirë ambientin ku punoni dhe magazinoni këto produkte. Pajisjet elektrike dhe ato ndihmëse që ndodhen në ambientet ku punohet duhet të jenë fikur me kohë për të siguruar që ato janë ftohur gjatë fillimit të punës. Çdo lloj shkëndije, duke përfshirë dhe pajisjet elektrike duhet të shmanget. Mbani të mbyllura shumë mirë kutitë e këtyre produkteve. Largoni elementë, bimë apo kafshë me ndjeshmëri ndaj avujve të tretësve, që ndodhen në zonën e emetimit të këtyre avujve.

Connected Systems: Nëpërmjet Connected Systems, produktet e testuara janë të optimizuara në mënyrë të tillë që të mos ketë ngjyrosje të errët të shkaktuar nga ndërveprimi kimik midis llakut dhe ngjitësit në rastin e përpunimit profesional.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speziale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia jonë përcaktohet ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjën ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.

